



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

**Shënim 2:** Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

**Naureda Llagami:** Përshëndetje të gjithëve!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, përveç zonjës Shehu, e cila për arsye shëndetësore, sot e ka të pamundur që të jetë në këtë mbledhje.

Dëshiroj t’ju informoj që sot në rendin e ditës janë 16 çështje, duke përfshirë edhe dy caktimet urgjente që kërkohen nga dy gjykatat në nevojë. Konkretisht kemi:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”.

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura lidhur me emërimin e përkohshëm të 8 Ndhmësve Ligjorë, që kanë mbaruar studimet e tyre në vitin 2020.

Shqyrtimi i tre projektvendimeve të cilat kanë të bëjnë me rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve për një pozicion pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe dy pozicione pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}...”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. {...}”.

Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ato ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Më tej do vijohet me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}.

Ky është rendi i ditës për ditën e sotshme.

Nëse kemidiskutime?

Nëse jo, kalojmë me çështjen e parë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, relatore e të cilës është zonja Brikena Ukperaj.

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 328, datë 17.09.2020, ka vendosur verifikimin e plotësisht të tre kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë për gjyqtaren {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.2.2020 dhe për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84 datë 26.2.2020, nr. 245 datë 09.07.2020.

Pas marrjes së këtij vendimi, bazuar në dispozitat ligjore të cilat përmenden në relacion, Këshilli me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020, ka vendosur:

“I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

...3. Për gjyqtaren {...} – relatore znj. Brikena Ukperaj – nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha”.

Pas marrjes së këtij vendimi, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit, duke u kryer veprimet si më poshtë:

Më datë 25.09.2020, gjyqtarës i është njoftuar gjyqtarës vendimi për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar dhe emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike.

Më datë 28.09.2020 gjyqtarja ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se është dakord me vlerësuesit.

Më tej gjyqtarja i është dërguar dhe kryetarit të gjykatës “Formulari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit” së bashku me njoftimin për afatet e plotësimit të tij. Nga ana e kryetarit të gjykatës nuk janë dërguar në Këshill aktet e vlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 88 të Ligjit për Statusin.

Më tej nga ana e relatorit dhe Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin është kërkuar informacion për pjesëmarrjen e gjyqtarës në Programin e Formimit Vazhdues, informacion që është përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. 787/1 prot, datë 12.10.2020.

Po kështu janë kërkuar të dhëna për verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarës, informacion i cili është dërguar në rrugë elektronike nga ILD më datë 08.10.2020.

Ndërkohë që procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar nuk ka përfunduar, Këshilli me vendimin nr. 595, datë 26.11.2020, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë, për të tre pozicionet, ka vendosur përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për znj. {...}.

Pas përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kandidatës, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 nuk mund të vazhdojë. Kjo procedurë vlerësimi, në rastin konkret ka filluar për shkak të kandidimit për ngritje në detyrë, dhe bazohet në nenin 97, pika 1 të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se:

1. Magjistrati vlerësohet me procedurë të përshpejtuar, sipas kërkesës së tij, në rastet kur kërkohet të transferohet ose ngrihet në detyrë dhe kur vlerësimi i fundit është realizuar para më shumë se dy viteve. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar kryhet sipas parashikimeve të këtij ligji për aq sa është e mundur.”

Në vendimin e KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, konkretisht neni 22 pika 1 të tij, janë përcaktuar rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional gjatë periudhës kalimtare. Këto rregulla parashikojnë detyrimin e Këshillit që, në çdo rast ngritjeje në detyrë apo lëvizje

paralele, të bëjë vlerësim të përshpejtuar, pa kërkesë të gjyqtarit, duke respektuar rregullat e vlerësimit të përshpejtuar me afate të përgjysmuara. Zhvillimi i kësaj procedure, e cila inicohet pas kërkesës së gjyqtarit për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë dhe kualifikimit të tij për plotësim të kriterëve ligjore, synon të garantojë zhvillimin e një procesi të shpejtë, efektiv dhe të njëjtë vlerësimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, për të siguruar të paktën 1 vlerësim profesional në kohë, të njëjtë dhe real me atë të kërkesës së gjyqtarit për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

Në kushtet kur procedura e ngritjes në detyrë, për shkak të së cilës ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 ka përfunduar dhe njëkohësisht gjyqtarja {...} nuk është përfshirë në programin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2020 miratuar me vendimin e KLGJ-së nr. 276, datë 10.12.2019, rezulton se, shkak për të cilin procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar ka filluar nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi i kësaj procedure për shkak të mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016, Këshilli zbaton Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Në rastin konkret, me deklarin e përfundimit të procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtarit, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më. Për pasojë vijimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar nuk mund të vazhdojë. Ndërkohë viti kalendarik 2019 për të cilin kishte filluar kjo procedurë vlerësimi për gjyqtaren, do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit në të cilën ai bën pjesë,

sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit për Statusin, duke qenë se gjyqtarja ka një eksperiencë pune mbi 15 vjet.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi i procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2019 për gjyqtaren {...}, për shkak të përfundimit të procedurës për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 595, datë 26.11.2020.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84, pika 2 të Ligjit për Statusin.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për përfundimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar t'i njoftohet gjyqtarës {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja e tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të bërë?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për

gjqtare {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 595, datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.

3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brunilda Kadi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brunilda Kadi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës.

Përpara se të kalojmë, të lutem, Albani të përfshihet “online”.

Atëherë, Albani është “online”.

Kështu, kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me projektvendimin “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}”.

Relatore e këtij projekt-akti është zonja Kadi.

*Brunilda Kadi:* Faleminderit, Kryetare!

Situata e zonjës {...} është e njëjtë me atë të zonjës {...}. Unë shkurtimisht po ndalem në disa momente.

Me vendimin nr. 328, datë 17.09.2020, Këshilli ka vendosur verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit. Mbas këtij vendimi, ka filluar procedura e përshpejtuar e detyruar e vlerësimit etik dhe profesional me vendimin nr. 337, datë 24.09.2020.

Janë kryer disa veprime për këtë procedurë. Ndërkohë që nuk ka përfunduar kjo procedurë, Këshilli me vendimin e datës 26.11.2020, pasi ka shqyrtuar kërkesën e kandidates për tërheqje nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë, ka vendosur përfundimin pa vendim përfundimtar të kësaj procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për të tre pozicionet.

Në këto kushte, kur procedura e ngritjes në detyrë, për shkak të së cilës kishte filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, për vitin kalendarik 2019, ka përfunduar, dhe gjyqtarja {...} nuk është përfshirë në programin e vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2020, rezulton se shkak për të cilin kjo procedurë e vlerësimit të detyruar të përshpejtuar ka filluar, nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i saj ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

Në këto kushte, propozohet për t'u marrë vendimi me përmbajtjen:

1.Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 594, datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2.Viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.

3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Kadi!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, viti kalendarik 2019, për gjyqtaren {...}, për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 594, datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Viti kalendarik 2019 do të përfshihet në periudhën 5-vjeçare të vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ai bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 84 pika 2 të Ligjit për Statusin.

3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Medi Bici):

3.1 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.2 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Durrës;

3.3 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.4 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.5 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.6 Për emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.7 Për emërimin e përkohshëm të Znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

3.8 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtare)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*

*Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relator z. Medi Bici):

3.1 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.2 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Durrës;

3.3 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.4 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.5 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.6 Për emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

3.7 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

3.8 Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në njësinë e shërbimit ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në 8 projekt-aktet e radhës, që kanë të bëjnë me emërimin e përkohshëm të Ndhimësve Ligjorë. Për më shumë detaje do doja t’ia jepja fjalën z. Medi Bici.

*Medi Bici:* Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, miratoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhimës Ligjor. Një vendimmarrje e tillë u bazua në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin

nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (nenet 53, 55 dhe 83), në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (neni 165), si dhe në nenin 6, të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Qëllimi i tij është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit, si dhe të pasurisë dhe të figurës (për disa kategori kandidatësh), të kandidatit për Kancelar, për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit, përfshirë këtu dhe kandidatit për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit, të cilët kanë përfunduar formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020.

Ndërkohë që subjektet e këtij vendimi janë listuar në pikën 2, shkronja “a” të Kreut I, dhe konkretisht janë konsideruar si të tillë:

i) kandidati për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për Kancelar, për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë ose për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit;

ii) kandidati fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për Kancelar, për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë ose për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit;

iii) kandidati për Kancelar, për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë ose për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit;

iv) kancelari në detyrë, Këshilltari Ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe Ndhmësi Ligjor në detyrë në gjykatat administrative.

Gjithashtu në Kreun XIV, të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të KLGJ-së, titulluar “Dispozita kalimtare dhe të fundit” ndarë në tre seksione, konkretisht A, B dhe C rregullohet mënyra sesi do të bëhet verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës:

(i) për kandidatët për Këshilltarë Ligjorë në Gjykatën e Lartë, që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020.



(ii) për kandidatët për Ndhmës Ligjorë në gjykatat e apelit, që përfundojnë Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020.

(iii) për kandidatët për Këshilltarë Ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për Ndhmës Ligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Lidhur me kandidatët për Ndhmës Ligjorë, që kanë përfunduar formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, është parashikuar që emërohen përkohësisht deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Emërimi kushtëzohet nga krijimi i njërive të shërbimit ligjor, pranë gjykatave të apelit dhe shpalljes së vendeve të lira .

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendim nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njërive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, ka krijuar njësitë e shërbimit ligjor, si pjesë e organikës së gjykatave të apelit.

Ndërsa me Vendimin nr. 586, datë 20.11.2020 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e Ndhmësit Ligjor, në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur shpalljen e 17 vendeve vakante, në pozicionin e Ndhmësit Ligjor. Përkatësisht :

- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë - 6 Ndhmës Ligjorë;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës - 1 Ndhmës Ligjor;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë - 2 Ndhmës Ligjorë;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Korçë - 1 Ndhmës Ligjor;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Shkodër - 1 Ndhmës Ligjor;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Vlorë - 3 Ndhmës Ligjorë;
- Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 Ndhmës Ligjorë.

Në zbatim të pikës 2 të këtij vendimi, nga ana e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, është bërë njoftimi i datës 23.11.2020 “Për shprehje interesi”, publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me anë të njoftimit, janë ftuar të gjithë kandidatët, që kanë përfunduar me sukses Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020, të shprehin interesin për pozicionet e lira të shpallura.

Pasi kanë marrë dijeni, kanë shprehur interesin e tyre me shkrim 8 kandidatë, të cilët kanë përcaktuar preferencat e tyre si më poshtë:

1. Znj. {...} – pranë Gjykatës së Apelit Tiranë
2. Znj. {...} – pranë Gjykatës së Apelit Durrës
3. Znj. {...}- pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
4. Znj. {...}- pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
5. Znj. {...} - pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
6. Znj. {...} – pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
7. Znj. {...}- pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
8. Z. {...} - pranë Gjykatës së Apelit Tiranë

Lidhur me mënyrën e emërimit, ai bëhet në bazë konkurrimi, duke marrë parasysh kriteret sipas radhës: a) Renditja në listën e kandidatëve; b) Çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) Vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

Renditja e kandidatëve në listë, sipas Vendimit nr. 30, datë 22.09.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, rezulton si më poshtë :

1. Znj. {...}
2. Znj. {...}
3. Znj. {...}
4. Znj. {...}
5. Znj. {...}
6. Znj. {...}
7. Znj. {...}
8. Z. {...}

Në bazë të shprehjes së interesit nga ana e kandidatëve, rezulton se 5 prej tyre kanë kërkuar të emërohen, në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit

Tiranë. Me vendimin nr. 586, datë 20.11.2020 “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë shpallur 6 vende vakante në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në kushtet ku të 5 kandidatët plotësojnë kriteret formale për t’u emëruar në pozicionin e Ndhmësit Ligjor, vlerësojmë se është i mundur emërimi i tyre në këtë gjykatë.

Znj. {...}, e listuar e dyta ndër kandidatët, ka shprehur interesin për t’u emëruar pranë Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Apelit Durrës. Në këtë gjykatë është shpallur 1 vend vakant, për të cilin znj. {...} është candidate e vetme. Sa më sipër, vlerësohet të bëhet emërimi i përkohshëm i kandidatit në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës, pasi plotëson kriteret ligjore për t’u emëruar.

Ndërsa kandidatet, znj. {...} dhe znj. {...}, kanë shprehur interesin për t’u emëruar në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sjellim në vëmendje se këto candidate, në bazë të nenit 53, pika 11, e Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun XIV, Seksioni B, pika 148 dhe Kreu VIII, të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kërkesat e kushtet shtesë, të parashikuara në Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi nr. 424, datë 12.10.2020, i KLGJ-së, ka parashikuar në Kreun VIII procedurën që ndiqet nga Këshilli dhe relatori, për verifikimin e figurës së kandidatit për në shërbimet e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Për sa më sipër, për kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}, është e nevojshme të reflektohet në procedurat e verifikimit statusi i tyre si kandidatë për në shërbimet e gjykatave të posaçme.

Vendet vakante për Ndhmës Ligjor në Gjykatës e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë 3, ndërsa kandidatët janë 2, për këtë arsye vlerësohet se znj. {...} dhe znj. {...} plotësojnë kushtet për t’u emëruar përkohësisht.

Nisur nga numri i kandidatëve dhe numri i vendeve vakante (shpallur me Vendimin nr. 586, datë 21.11.2020, të KLGJ-së) në njësitë e shërbimit ligjor, pranë gjykatave të apelit, si dhe strukturën administrative dhe atë buxhetore të këtyre gjykatave, vlerësojmë se është e mundur emërimi i përkohshëm i 8 kandidatëve për Ndhmës Ligjorë, pranë gjykatave respektive.

Në sa më sipër, i propozohet Këshillit, miratimi i 8 projekt-vendimeve:

1. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

3. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Për emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

7. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

8. Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Struktura e 8 projektvendimeve është e njëjtë.

Në pikën 1, të projektvendimeve, përcaktohet emërimi i përkohshëm i Ndhmës Ligjor në pozicionin e Ndhmës Ligjor, në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë gjykatave të apelit përkatëse, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Komisioni përkatës, i cili e ka filluar këtë punë.

Në pikën 2, është parashikuar që efektet juridike të këtij vendimi të fillojnë menjëherë, ndërkohë që në pikën 3, përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet

kandidatëve, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ashtu dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë si dhe Gjykatës së Apelit.

Gjithashtu në pikën 4 të vendimit, përcaktohet e drejta e ankimit të kandidatit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në fund parashikohet që hyrja në fuqi e tij është në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Zonja Kryetare, meqenëse këto akte janë individuale, është e nevojshme që të kalojnë një nga një në votim.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Bici për relatimin!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin e parë, i cili ka të bëjë me Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Durrës, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Durrës.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës “Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës “Për emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmësës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmësës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmësës Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.



**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projektvendimin e radhës “Për emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e Ndihmësit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të Znj. {...}, në pozicionin e Ndihmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë tek projekt-akti i fundit që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e Ndhmëses Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë menjëherë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

4.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

4.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

4.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

4.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

4.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

4.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në 3 projekt-aktet e radhës të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. I pari ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale. Dy projekt-aktet e tjera kanë të bëjnë me rihapjen e procedurës së ngritjes

në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për dy pozicione, një në fushën e së drejtës civile dhe një në fushën e së drejtës penale. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe Shkodër, në secilin rast, nga një pozicion të lirë, në fushën e së drejtës civile dhe penale.

Lidhur me projektvendimet ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues.

Shkurtimisht mund t'ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, më datë 28.05.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në disa gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to në Gjykatën e Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale sipas Vendimit nr.177, si dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.178.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 15.06.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë, ndërsa vijonte të ekzistonte nevoja për plotësimin e tyre, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave. Konkretisht:

a) me Vendimin nr. 228, datë 02.07.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale; b) me Vendimin nr. 229, datë 02.07.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 19.07.2020, përsëri nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave. Konkretisht:

a) me Vendimin nr. 299, datë 10.09.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të

drejtës penale; b) me Vendimin nr. 298, datë 10.09.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 24.09.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave. Konkretisht:

a) me Vendimet nr. 390 dhe nr. 391, datë 07.10.2020.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 23.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Gjithashtu, pas krijimit rishtazi të një pozicioni të lirë, respektivisht në Gjykatën e Apelit Shkodër, Këshilli, më datë 07.10.2020, vendosi të hapte procedurën e ngritjes në detyrë pranë kësaj gjykate, me Vendimin nr. 393, datë 07.10.2020, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Brenda afatit të kandidimit për këtë procedurë ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 23.10.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave. Konkretisht:

a) me Vendimin nr. 542, datë 05.11.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale; b) me Vendimin nr. 543, datë 05.11.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile; c) me Vendimin nr. 544, datë 05.11.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Brenda afatit të kandidimit për këto tre procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 20.11.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Ndërsa në Gjykatat e Apelit Korçë dhe Shkodër, vijojnë të ekzistojnë pozicionet e lira në fushat përkatëse të së drejtës si më lart, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”,



të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar tre projektvendime për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në këto dy gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm.

Sa i përket përmbajtjes së tre projektvendimeve, ato janë të strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e rihapjes së këtyre procedurave të ngritjes në detyrë, me përjashtim të afatit të kandidimit, i cili mbetet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të projektvendimeve, duke konsideruar se afati ligjor minimal i kandidimit është “të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës” .

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Tashmë, meqë ditën e sotme po shqyrtohet projektvendimi, duke konsideruar afatin minimal të kandidimit, pra të paktën 2 javë nga data e shpalljes së procedurës, propozoj që Këshilli, sa i përket afatit të kandidimit, të konsiderojë datën 28.12.2020. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, jemi dakord me propozimet, sidomos propozimin e afatit?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, kalojmë projekt-aktet.

Projekt-akti i parë ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 28.12.2020.

Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** (Nuk dëgjohej vota e zotit Toro).

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, me afat kandidimi deri më datë 28.12.2020. *(Kryetarja gabimisht kapërcen dhe lexon si të miratuar projekt-aktin e radhës, pra pozicionin në fushën civile pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, ndërkohë më lart u miratua “Rihapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 28.12.2020”. Ndërsa, duke menduar si të miratuar projekt-aktin e dytë që u trajtua ën fakt nga relatori z. Toro në relacion, kalon dhe hedh për votim projekt-aktin e tretë, si më poshtë).*

Kemi projekt-aktin e radhës “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”. Jemi dakord me projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Një sekondë, - Albani nuk është në linjë?

**Alban Toro:** Më fal, se pati një ndërprerje.

Dakord.

*(Ripërsëritet votimi nga zonja Luli dhe zoti Muharremaj në vijim).*

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e së drejtës penale, me afat kandidimi deri më datë 28.12.2020.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtare)
- 10. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimeve “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Fatmira Luli).

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me një nga projekt-aktet shumë të rëndësishme për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Ky projekt-akt, tashmë i hap rrugën emërimit të punonjësve të rinj dhe profesional, me integritet në administratën gjyqësore dhe për më shumë detaje, unë do doja që t’ia jepja fjalën relatores së projekt-aktit, znj. Fatmira Luli.

*Fatmira Luli:* Faleminderit, Kryetare!

Projekt-akti dhe relacioni janë konsultuar edhe në Komision edhe me partnerët tanë USAID dhe EURALIUS, është rishikuar disa herë prej disa muajsh, dhe tani, përfundimisht kemi sjellë një draft final, i cili i paraqitet për miratim mbledhjes plenare, në të cilin janë parashikuar në mënyrë të detajuar rregullat që vijnë në përputhje edhe me dispozitat ligjore që parashikon ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” në Shqipëri dhe ligji për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, po ashtu edhe në përputhje me aktet

dhe mendimet e Këshillit të Ministrave për nëpunësin civil, në rastet kur nuk parashikohen rregulla të detajuara nga aktet tona.

Projekti “Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë” përbën një nga aktet më të rëndësishme që miratohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatimin e ligjit nr.98/2016 dhe konkretisht, nenet 54 pika 7, neni 57 pika 13 dhe neni 58 pika 6 e ligjit, të cilët autorizojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor për nxjerrjen e këtij akti nënligjor.

Projektvendimi është titulluar “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, dhe përbëhet nga 44 nene, në gjashtë krerë, ku secili prej tyre përmban procedura specifike të detyrueshme për subjektet që i nënshtrohen këtij vendimi.

Fillimisht patëm disa sugjerime për titullin nga partnerët, që të përcaktoheshin kategoria e nëpunësve civilë gjyqësorë që do të përfshiheshin në këtë vendim, por meqenëse kjo është detajuar tek pjesa e subjekteve në kreun e parë, ne gjykuam që të lihej pa përcaktuar në titull për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Propozimi ishte që në këtë titull, të shtohej edhe fjala “për disa pozicione”. Ndërkohë që, drafti që keni përpara, i ka të përcaktuar tek neni 2 “Subjektet” dhe nuk e kemi gjykuar ta lëmë në titull. Kjo vlen të gjykohet nga kjo mbledhje, në qoftë se keni sugjerime për të ndryshuar emërtimin.

Në kreun e I përmbahen dispozita të përgjithshme të cilat përcaktojnë objektin, subjektet, përkufizimet e termave të përdorura në projektvendim. Gjithashtu, në nenet 4 dhe 5 të tij vendoset mënyra e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, ku përparësi i jepet listës së nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas një radhe të përcaktuar, bazuar kjo edhe në ligjin tonë edhe në aktet e shërbimit civil të Këshillit të Ministrave.

Subjekte të këtij vendimi nuk janë të tërë kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë, por janë një kategori e caktuar, të cilët janë të përcaktuar në nenin 2 të këtij vendimi, të cilët janë: kryesekretari, sekretari, nëpunësi i financës, nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, nëpunës të burimeve njerëzore, të teknologjisë së informacionit, të arkivit, marrëdhënieve me publikun, me median dhe jashtë, dhe nëpunës të tjerë që punojnë në gjykatë për nevoja specifike për burimet njerëzore të gjykatave. Pra në këtë nuk përfshihen ndihmësit, këshilltarët dhe kancelarët e gjykatave.

Në këtë dispozitë të kreut të parë përcaktohet qartë edhe radha e plotësimit të vendeve në shërbimin civil, ku prioritet i jepet plotësimit të vendeve të lira nga nëpunësit të cilët janë regjistruar në listën e nëpunësve civilë gjyqësorë sipas një radhe të caktuar: a) ka të drejtë të rikthehet në zbatim të një vendimi gjyqësor të formë së prerë (kjo lidhur edhe me afatet në të cilën një vendim është bërë i ekzekutueshëm); b) ka të drejtë të rikthehet, për shkak të pezullimit, nuk po ushtron detyrën, sipas neneve 67 dhe 68 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”; c) ka të drejtë të transferohet, sipas nenit 66 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

Nëse vendi bosh plotësohet sipas kësaj radhe, ai do të plotësohet sipas procedurës së lëvizjes paralele; procedurës së ngritjes në detyrë; procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Këtë proces e inicion Këshilli i Lartë Gjyqësor, pastaj procedurat e mëtejshme për njoftimet e vendit i vazhdon Këshilli i Gjykatës.

Në kreun e II përcaktohet qartë procedura e lëvizjes paralele dhe plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet kësaj procedure.

Shpallja fillimisht bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa njoftimi publik për kushtet dhe procedurat e lëvizjes bëhet nga Këshilli i Gjykatës.

Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza, të cilat janë verifikimi paraprak i kandidatëve që përmbushin kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe vlerësimi profesional i tyre.

Verifikimin paraprak i kandidatëve, ndiqet nga kancelari, i cili pasi vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, vendos për kualifikimin ose moskualifikimin e tyre për në fazën pasardhëse të vlerësimit nga Këshilli i Gjykatës. Një kompetencë e tillë e kancelarit është parashikuar shprehimisht në ligj, vetëm në rastin e procedurës së pranimit, por në këtë projektvendim, ky rregullim është vendosur dhe për procedurën verifikimit paraprak në lëvizjen paralele dhe në ngritjen në detyrë.

Në shumë raste ne jemi detyruar për analogji t’i përdorim dhe të bëjmë edhe kalime sepse ligji në shumë dispozita nuk është i qartë dhe nuk i ka rregullat shumë të përcaktuara për të tëra këto procedura, si për lëvizjen paralele, ashtu edhe për ngritjen në detyrë. Meqenëse ligji na ka lënë mundësinë që këto procedura t’i rregullojmë me këtë akt normativ, janë parashikuar këtu, në mënyrë të detajuar, rast pas rasti se si duhet të

bëhet ky plotësim i vendeve, çfarë rregulli dhe çfarë procedure duhet ndjekur në rastin e lëvizjes paralele dhe/ose ngritjen në detyrë; dhe në fund për pranimin.

Në nenin 11 është parashikuar procedura që duhet të ndjekë Këshilli i Gjykatës në vlerësimin e kandidatit, duke përcaktuar dhe pikëzimin për secilin nga kriteret e parashikuara në nenin 57, pika 10 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

Në nenin 57, pika 9 të ligjit, në rastin e lëvizjes paralele është parashikuar mundësia e zhvillimit të një interviste me kandidatët, në ndryshim nga procedura e ngritjes në detyrë, në të cilën zhvillimi i intervistës me kandidatët është e detyrueshme. Grupi i punës gjykoj që në këtë fazë, në rastin e lëvizjes paralele, në qoftë se bëhet fjalë për lëvizje brenda gjykatave ose brenda një gjykate, e gjykoj që të mos e përfshinte intervistën si pjesë të këtij vlerësimi, dhe ta linte vetëm me vlerësimin e dokumentacionit dhe të kushteve të tjera që parashikon dispozita përkatëse (*ka shkëputje të linjës dhe nuk dëgjohet fjala*)... e kandidatit që do emërohet në përputhje me procedurën e lëvizjes paralele në gjykata.

Këshilli i Gjykatës, në përfundim të vlerësimin, i rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara, si dhe i njofton individualisht ata për rezultatin si dhe të drejtën e ankimit administrativ sipas nenit 12 të projektvendimit.

Në përfundim të procedurës Këshilli i Gjykatës, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë, ose, nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur. Për secilën nga rastet, parashikohet njoftimi KLGJ-së për rezultatet e procedurës.

Në nenin e fundit të këtij kreu, rregullohet në mënyrë të detajuar procedura e nxjerrjes së aktit të emërimit të nëpunësit civil gjyqësor, e fillimit të detyrës dhe të efekteve financiare. Në këtë nen është parashikuar edhe rasti kur kandidati fitues nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme. Në këtë rast Këshilli i Gjykatës vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ individual të emërimit, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe vazhdimin e emërimit për vendin e personit të renditur në radhë në listën e kandidatëve i cili është pas fituesit dhe ka fituar mbi 70 pikë në këtë vlerësim.

Në kreun e III është parashikuar dhe rregulluar procedura e ngritjes në detyrë. Si në rastin e lëvizjes paralele, edhe në rastin e ngritjes në detyrë, shpallja e njoftimit, bëhet



sipas të njëjtës procedurë të parashikuar në nenin 6 të projektvendimit. Në këtë rast janë mbajtur në konsideratë edhe kriteret e veçanta, të përcaktuara në nenin 56, nga pika 4 deri në pikën 8 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, si kushte minimale shtesë për ngritjen në detyrë.

Vijimi i mëtejshëm i procedurës është paraqitur në dy variante. Sipas variantit të parë, të propozuar nga ana e Komisionit, konkurrimi për procedurën e ngritjes në detyrë përfshin tre faza, në ndryshim nga varianti i dytë, i cili ka paraqitur zhvillimin e procedurës në dy faza.

Kemi pasur diskutime për këto procedura të ngritjes në detyrë dhe meqenëse Komisioni e gjykoi që Këshilli t’i linte me dy variante: Varianti i parë i cili të rregullonte procedurën e ngritjes në detyrë nëpërmjet Komisionit të Pranimit, veç Këshillit që ka kompetencat e tij; dhe Varianti i dytë që parashikon që kjo të mos bëhet me Komision Pranimi, por të bëhet nga Këshilli. Për këtë shkak, në draft i keni të dy variantet dhe i lihet kësaj mbledhjeje plenare që të vendosë dhe të gjykojë variantin më të përshtatshëm. Por ne kemi gjykuar që është më praktik dhe më i përshtatshëm rasti kur nuk ngrihet Komisioni Pranimi për rastin e ngritjes në detyrë; është lënë vlerësimi i kësaj procedure vetëm nëpërmjet dokumentacionit dhe intervistës që do jetë pjesë përbërëse e vlerësimit në pikë, që do të vendosi Këshilli i Gjykatës, për të pranuar dhe për të emëruar nëpunësit, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Procedura e variantit të dytë është e njëjtë me procedurën e lëvizjes paralele.

Tek vlerësimi nga Këshilli i Gjykatës, në të dy variantet, është parashikuar zhvillimi i detyrueshëm i intervistës, që në rastin e lëvizjes paralele u hoq sepse ligji e parashikonte fakultative. Kështu, në nenet përkatëse të projektvendimit, struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve, është parashikuar e ndarë veç për dokumentacionin e dorëzuar dhe për intervistën e strukturuar me gojë.

Këshilli i Gjykatës, në përfundim të vlerësimit, i rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara, dhe i njofton individualisht ata për rezultatin si dhe të drejtën e ankimit administrativ sipas nenit 20 të projektvendimit.

Si në rastin e procedurës së lëvizjes paralele, Këshilli i Gjykatës, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë, në fund të procedurës, dhe nëse asnjë nga kandidatët nuk

ka fituar mbi 70 pikë, përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur, duke njoftuar, në çdo rast, KLGJ-në për rezultatet e procedurës.

Në nenin e fundit të këtij kreu, rregullohet në mënyrë të detajuar procedura e nxjerrjes së aktit të emërimit, e fillimit të detyrës dhe të efekteve financiare. Në këtë nen është parashikuar edhe rasti kur kandidati fitues nuk paraqitet në detyrë, ashtu sikurse edhe në lëvizjen paralele, për të cilën Këshilli anulon aktin administrativ dhe njofton nëpunësit civil pasardhës në listë që ka fituar mbi 70 pikë (sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj).

Kreu i IV rregullon pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

Në nenin 23 dhe vijues të projektvendimit janë vendosur dispozita të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, procedurën e shpalljes, njoftimit të fillimit të procedurës për pranimin në shërbimin civil gjyqësor si dhe kriteret e pranimit. Si në dy procedurat e tjera shpallja për pranimin në shërbimin civil gjyqësor bëhet nga KLGJ-ja dhe më pas njoftimi i procedurës vijohet nga Këshilli i Gjykatës, sipas përcaktimeve të nenit 24 pika 2 të projektvendimit.

Neni 26 i projektvendimit parashikon Komisionin e Pranimit. Këtu rregullohet për herë të parë Komisioni i Pranimit në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, procedurën për ngritjen e tij, përbërjen dhe kuorumin vendimmarrës, si dhe pjesëmarrjen e detyrueshme të anëtarëve të caktuar në komision, me përjashtim të pengesave ligjore.

Konkurrimi për pranimin në shërbimin civil gjyqësor zhvillohet në dy faza, që janë verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara në njoftim dhe vlerësimi i kandidatëve. Verifikimi paraprak bëhet nga Kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i Pranimit dhe Këshilli. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht 60 pikë për vlerësimin me shkrim dhe 40 pikë për vlerësimin nga Këshilli. Kandidatët, që kanë marrë mbi 42 pikë (pra mbi 70% të pikëve), gjatë fazës së vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Pranimit, kualifikohen për vlerësimin nga Këshilli.

Në vijim, është Komisioni i Pranimit që i njofton Këshillit, listën e kandidatëve të renditur sipas pikëve apo përfundimin e procedurës pa asnjë të kualifikuar. Kandidatët njoftohen individualisht për rezultatet e procedurës dhe kanë të drejtën e ankimit administrativ, sipas nenit 31 të këtij projektvendimi.

Në të tre rastet, për kujtesë është parashikuar që të bëjnë ankim ndaj këtyre procedurave. Në rastin e Kreut të II dhe të III, ankimi është me afat më të shkurtër dhe i drejtohet Këshillit, ndërsa edhe këtu njoftohen individualisht për procedurën të tërë personat që kanë të drejtën e ankimit dhe që nuk fitojnë këtë procedurë me minimumin e pikëve që parashikon për personat që duhet të kualifikohen.

Në nenin 32 parashikohet e drejta e kandidatëve, të renditur në listën e kandidatëve, për të paraqitur kërkesë pranë Këshillit të Gjykatës, i cili më pas fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës, duke marrë parasysh renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim nga Komisioni i Pranimit, si dhe pikëzimin e përcaktuar për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë dhe vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës. Kandidatët që marrin 70% të pikëve totale të vlerësimit kualifikohen për fazën e emërimit nga Këshilli.

Neni 33 i projektvendimit përcakton rregulla për arsyetimin, publikimin, njoftimin dhe ankimin e vendimit të Këshillit të Gjykatës për rezultatet e procedurës së emërimit. Në vijim neni 34 parashikon emërimin paraprak të kandidatit fitues, rastet e bërjes përfundimtar të këtij vendimi emërimi si dhe rivlerësimin e këtij vendimi dhe marrjen e një vendim të ri pas dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës.

Nenet 35 deri 38 të projektvendimit, parashikojnë fillimin e detyrës dhe të efekteve financiare, si dhe fillimin të periudhës së provës, përfundimin e saj dhe vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës pas përfundimit të kësaj periudhe prove.

Neni 39 parashikon emërimin e përkohshëm, si një procedurë për plotësimin përkohësisht të një pozicioni pune, i cili për arsye të parashikuara nga ligji është i lirë përkohësisht. Kështu, sipas këtij parashikimi kandidatët në listën e kandidatëve, të pa emëruar ende në ndonjë pozicion sipas këtij projektvendimi, mund të emërohen nga Këshilli i Gjykatës, në mënyrë të përkohshme, në një pozicion pune, i cili për arsye të parashikuara nga ligji është i lirë përkohësisht. Këshilli, përzgjedh kandidatin fitues që ka mbetur në listën e kandidatëve dhe që i përshtatet kërkesave të vendit të punës. Përzgjedhja dhe njoftimi i kandidatëve bëhet, sipas pikëve, në bazë të renditjes së tyre në listën e kandidatëve. Emërimi i një kandidati në mënyrë të përkohshme:

•Së pari, nuk i heq atij të drejtën për t'u emëruar në mënyrë të përhershme në rast të krijimit të një pozicioni pune të lirë, gjatë kohës së vlefshmërisë së listës

•Së dyti, nuk konsiderohet periudhë prove, në rast se kandidati emërohet më pas në pozicion pune në mënyrë të përhershme.

•Së treti, procedura e parashikuar sipas këtij neni, ndiqet vetëm pasi të ezaurohet ofrimi i vendit të lirë përkohësisht, nëpunësve civilë gjyqësorë të regjistruar në listën e administruar nga KLGJ-ja (të përcaktuar në Kreun e I).

•Së fundi, nëpunësit e emëruar në mënyrë të përkohshme i nënshtrohen rregullave të procedimit disiplinor sipas legjislacionit për nëpunësin civil gjyqësor.

Kreu i V-të, parashikon kushtet e sigurisë dhe procedurat shtesë të verifikimit të kandidatëve për nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në gjykuam që t'i vendosim më vete, duke qenë se këto rregullime janë rregullime të detajuara për nëpunësin civil që do të punojë në gjykatat e posaçme. Procedura do jetë e njëjtë. Në çdo procedurë të parashikuar në këtë ligj, do të shtohen kushtet shtesë të parashikuara në Kreun e V-të, të cilat janë kushtet e sigurisë përpara emërimit në detyrë, kontrolli i verifikimit të sigurisë dhe figurës, dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, si dhe dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Sipas nenit 41 të projektvendimit, gjatë këtyre procedurave, kandidati, bashkë me kërkesën për aplikim, plotëson dhe dorëzon pranë Këshillit përkatës dhe aktet e listuara në këtë nen. Bashkë me njoftimin për plotësimin e vendit të lirë, përcaktohet se Këshilli duhet të publikojë dhe formularë të aksesueshem "online", që duhet të plotësohen nga kandidatët si dhe çdo informacion të nevojshëm për mënyrën e plotësimit të tyre.

Neni 42 parashikon procedurat shtesë e verifikimit të kushteve të sigurisë. Kancelari, gjatë fazës së verifikimit paraprak, verifikon edhe rregullsinë e plotësimit dhe dorëzimit të akteve nga kandidatët, pasi mosplotësimi dhe mosdorëzimi i tyre, përbën shkak për moskualifikim të kandidatit për fazat e tjera të procedurës.

Këshilli, pasi kryen procedurën e vlerësimit i rendit kandidatët që kanë fituar mbi 70% pikë, në një listë, sipas rendit alfabetik, dhe ia dërgon atë, së bashku me aktet e

depozituara Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, i cili kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën brenda 120 ditëve. Një procedurë e tillë është parashikuar me qëllim për të shmangur verifikimin e pasurisë dhe figurës së të gjithë kandidatëve, duke e kufizuar këtë verifikim vetëm për kandidatët të cilët në procedurën e vlerësimit arrijnë të fitojnë mbi 70% pikëve. Në këtë mënyrë angazhimi në procedurë i Komisionit të Posaçëm, do të jetë më i vogël, duke marrë në konsideratë natyrën e tij si një organ kolegjal, anëtarët e të cilit ushtrojnë këtë detyrë me kohë të pjesshme, pa u shkëputur nga funksionet e tyre të zakonshme.

Në procedurën e parashikuar në këtë nen, Komisioni gjatë draftimit është munduar të ruajë të njëjtin standard verifikimi me Vendimin e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Neni 43 i projektvendimit parashikon vendimin e Këshillit të Gjykatës në përfundim të procedurës së verifikimit. Pra, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve të sigurisë, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin ose moskualifikimin e kandidatit. Këshilli në procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatit për në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, krahas procedurës së parashikuar në këtë kre, zbaton edhe procedurat e parashikuara në këtë projektvendim, sipas rastit, për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

Kreu i VI-të ka rregulluar dispozitat e fundit të këtij akti dhe përbëhet nga dy nene. Konkretisht neni 44 parashikon se Këshilli i Lartë Gjyqësor, menjëherë pas miratimit të këtij projektvendimi, do të procedojë me draftimin dhe miratimin e një udhëzimi, i cili do të vendosë rregulla shumë të detajuara për zbatimin e këtij projektvendimi. Duhet të kemi parasysh që këto janë akte të reja për gjykatën dhe për këtë shkak ne kemi gjykuar që ky udhëzim do t'i ndihmojë shumë edhe Kancelarët, Kryetarët dhe Këshillat e Gjykatës, për të kuptuar në mënyrë më të detajuar se si do t'i zhvillojnë procedurat e vlerësimit të kandidatëve dhe prandaj ky udhëzim i ndihmon shumë për organizimin e të gjithë këtyre procedurave, i cili do të parashikojë në mënyrë shumë të detajuar rregullat se si do të zhvillohen edhe intervistat, provimi, vlerësimi i

dokumentacionit, i njohurive të të gjithë kandidatëve që do marrin pjesë në këtë konkurrim.

Ky projektvendim del në bazë dhe në zbatim të dispozitave konkrete ligjore të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, të cilat autorizojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor në nxjerrjen e këtij projektvendimi. Si i tillë, pra për shkak të natyrës së tij si akt nënligjor, ky projektvendim me miratimin nga Këshilli, botohet në faqen zyrtare të tij dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

Kush ka ndonjë pyetje ose kërkon ndonjë sqarim të mëtejshëm, jam e gatshme t’u përgjigjem.

**Naureda Llagami:** Faleminderit Fatmira, për relatimin ezaures të projekt-aktit.

Pa dashur që të shtoj atë që tha Fatmira, dua të theksoj faktin që është i projekt-akt i shumë konsultuar, me të gjithë gjykatat, me projektet, derisa ka arritur në formën që kemi ne sot. Kështu që, unë do ftoja të gjithë kolegët nëse kanë diskutime lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit dhe më pas, përpara se të kalojmë në votim, të diskutojmë të dy variantet që Fatmira propozoi për një nen, dhe më pas të kalohet në miratimin në tërësi të projekt-aktit.

**Ilir Toska:** Me leje?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Nuk kam gjë në parim me projekt-aktin, jam dakord. E vetmja gjë që unë desha të dija nga ana e Komisionit, është sa i përket dy varianteve të propozuara, pra atë për përfshirjen në procedurën e ngritjes në detyrë të një Komisioni Pranimi (kështu është emërtuar nga ana e Komisionit në projektvendim) apo mospërfshirjen e tij. Kush janë të mirat dhe të këqijat e përfshirjes ose jo të këtij Komisioni Pranimi? Kjo ishte ajo që do desha të dëgjoja nga ana e Komisionit. Përse ne do duhet të konsiderojmë ta fusim këtë Komision në procedurë dhe në eventualitet, çfarë të këqija ka nëse ky Komision nuk do të jetë pjesë e procedurës?

**Fatmira Luli:** Po! –mund të përgjigjem.

Komisioni i Pranimit në procedurën e ngritjes në detyrë, mendimi personal i Komisionit, anëtarëve të tij, por edhe nga konsultimet që kemi pasur me partnerët tanë, ideja ishte që këto procedura të jenë sa më të thjeshta dhe mos të ngarkohen me Komisione Pranimi, se edhe vetë ligji kur thotë për Komisionin e Pranimit, e ka përcaktuar kryesisht në rastin e pranimit në shërbimin civil. Komisioni i Pranimit, në rastin e ngritjes në detyrë, do të ishte të ngrihesh për vende shumë minimale sepse ngritja në detyrë në gjykata bëhet fjalë vetëm për pozicionin e sekretarit dhe kryesekretarit dhe do kishte një rast ose maksimumi dy raste në sektorë, nuk ndodh siç mund të ndodhë në administratën shtetërore, që ngritjet në detyrë bëhen në numër shumë më të madh. Këtu është numri shumë i kufizuar i procedurës për ngritjen në detyrë dhe si e tillë, duke qenë se kjo do bëhet brenda procedurës së një gjykate ose edhe në gjykata të tjera për personat që plotësojnë, e gjykojmë që mos të ngarkohesh procedura me Komision Pranimi dhe të bëhesh më e thjeshtë, të bëhesh vetëm nëpërmjet Këshillit të Gjykatës dhe Kancelarit që bën verifikimin paraprak. Në rastin e ngritjes në detyrë është intervista ajo që është shtuar dhe që është e detyrueshme, dhe që e ndan në një farë mënyre. Sepse gjykohet që, një person që punon sekretar gjyqësor në gjithë këto vite, është testuar, është vlerësuar, është njohur dhe nuk është e domosdoshme të ngrihet një Komision Pranimi për të vlerësuar njohuritë e tij (për rastin kur ai punon si sekretar gjyqësor). Thjesht për thjeshtim procedure dhe duke u nisur nga fakti që numri i këtyre rasteve është shumë minimal dhe nuk mund të investohet një Komision Pranimi; vetëm për një vend pune, të investosh një grumbull njerëzish, siç ndodh në rastin e pranimit në shërbimin civil, që është gjykuar që do vijë dikush nga jashtë sistemit, që ti je i detyruar edhe t'i vlerësosh njohuritë profesionale. Këtë e ke një njeri që e ke njohur dhe e ke testuar për vite, e ke vlerësuar, ia ke parë njohuritë, i ke dhënë edhe vlerësim pune dhe për këtë shkak kemi gjykuar që mos të ketë Komision Pranimi në këtë rast.

**Naureda Llagami:** Ndonjë koleg tjetër të lutem?

**Brikena Ukperaj:** Zonja Kryetare, mund të flas diçka?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Në vijim të asaj që tha Fatmira, unë e gjej me vend variantin e dytë, të mbështetur nga Komisioni (mesa kuptova edhe nga zonja Luli), por edhe nga

konsultimi me ligjin, më rezulton që, si tek lëvizja paralele edhe te ngritja në detyrë, nuk përfshin Komisionin e Pranimit. Pra është edhe një zgjidhje që vet ligjvënësi ia ka parashikuar procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, e ndryshme nga ajo e pranimeve të reja në shërbimin gjyqësor civil. Kështu që unë jam dakord me variantin e dytë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, ndonjë diskutim tjetër?

Nëse nuk kemi, kalojmë njëherë fillimisht kë variant do të marrim dhe më pas në tërësi aktin?

Meqë propozimi i Komisionit, gjithashtu i mbështetur edhe nga zonja Ukperaj, është varianti i dytë, a jemi dakord të gjithë me variantin dy?

**Maksim Qoku:** Na i saktësoni ju lutem variantin e dytë?

**Fatmira Luli:** Varianti i dytë është procedura që unë citova. Nuk ka Komision Pranimi. Vlerësimi bëhet..

**Maksim Qoku:** Pra, pa Komision Pranimi?

**Fatmira Luli:** Pa Komision Pranimi. Bëhet nga Kancelari...

**Maksim Qoku:** Ok!

**Fatmira Luli:** ...dhe ka vetëm intervistën e strukturuar, që është e detyrueshme. Thjesht nuk ka një Komision Pranimi që të vlerësojë njohuritë profesionale, siç bëhet në administratën publike. Ky është i vetmi ndryshim.

**Maksim Qoku:** Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim variantin e dytë? Jemi dakord apo jo?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.



**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, u pranua varianti dy.

Kalojmë në tërësi të gjithë projektvendimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë lidhur me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, KZHK ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 545,

datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për këtë projektvendim ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju them se:

Sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ushtron edhe funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

Funksioni kushtetues si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që lidhet me zhvillimin e karrierës gjyqësore, gjen rregullim të mëtejshëm në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 86, shkronja “ç”, ndërkohë që në shkronjën “ë” të kësaj dispozite, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Më tej, përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 48, ndërkohë që në pikën 7 të kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe për ata që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”.

Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, për kandidatin që ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës

penale, të shpallur me Vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, afati i kandidimit për të cilin ka përfunduar më datë 20.11.2020.

Duhet përmendur se, më datë 05.11.2020, përmes Vendimeve nr. 542, nr. 543 dhe nr. 544, Këshilli ka rihapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit Korçë dhe për dy pozicione të lira në secilën fushë të së drejtës (civile dhe penale) në Gjykatën e Apelit Shkodër, procedura në të cilat nuk aplikoi asnjë gjyqtar. Për rrjedhojë, në mungesë të kandidatëve në këto procedura ngritjeje në detyrë, nuk kishte vend për të vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për ta.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart, “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, do të duhet të caktojë dhe relatorin për kandidatin e vetëm që ka kandiduar, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për kandidatin e vetëm, z. Genti Dokollari për pozicionin e lirë, për të cilën fillon procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit sipas pikës 1 të projektvendimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Procedura e shortit

Futen fillimisht në enën e qelqit tre shiritat me emrat e secilit relator.

Z. Ilir Toska, znj. Marçela Shehu dhe z. Alban Toro.

I përzgjedhur nga shorti është z. Alban Toro.

**Naureda Llagami:** Hidhet në votim projekt-akti. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Vlorë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 545, datë 05.11.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

Për kandidatin z. Genti Dokollari, relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve të kushteve ligjore për kandidaten znj. {...}, të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Atëherë, zonja {...} ka konkurruar për tre pozicione të lira të shpallura me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 që bën fjalë për një pozicion të lirë në fushën e të



drejtës civile në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Znj. {...} ka kandiduar brenda afatit të kandidimit që ka përfunduar më datë 23 tetor 2020.

Me vendimin nr. 541, datë 05.11.2020 Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe zonjën {...}, për të cilën si relator jam caktuar unë.

Mbas kësaj kanë filluar procedurat standarde të verifikimit të tre kritereve formale të kandidimit, por edhe për dy kriteret e tjera për sa i përket pasurisë dhe figurës. Ndërkohë në tre vendimet për të cilat ka kandiduar zonja {...}, sikundër në të gjithë vendimet e tjera të Këshillit, është parashikuar që paraprakisht Këshilli të verifikojë plotësimin e tre kritereve formale, sa i përket “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në kushtet e papajtueshmërisë ambientale”, me qëllim hapjen e rrugës së procesit të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pjesë kjo e procesit të ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta, siç jemi në rastin konkret në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Pikërisht, referuar rregulimeve sa i përket verifikimit paraprak të tre kritereve formale, ky verifikim ka përfunduar. Janë marrë informacione, përveç sa kandidatja ka depozituar nga ana e saj, edhe nga gjykatat ku ajo ka ushtruar funksionin e gjyqtares (që janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier), sikundër është marrë informacion edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” ka rezultuar se zonja {...} është emëruar fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer stazhin profesional. Stazhi profesional ka filluar me Dekret të Presidentit të Republikës të datës 10 tetor 2012. Më pas ajo është emëruar përfundimisht me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 23.01.2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku vijon të ushtrojë edhe detyrën aktualisht.

Ndërkohë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier janë marrë ndarjet në seksione dhe dhoma. Është informacioni i hollësishëm në relacionin shpjegues. Kandidatja përgjithësisht ka qenë në dhomë civile, por ka edhe një periudhë që është në dhomë penale.

Nga verifikimi i këtij kriteri, rezulton që kandidatja të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 47 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale”, qoftë atë të përgjithshëm 7-vjeçare, ashtu edhe të “përvojës specifike” 5-vjeçare.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, rezulton që zonja {...} të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”, zonja {...}, në momentin e aplikimit ka plotësuar formularin përkatës, ndërkohë nuk ka ndonjë të dhënë që zonja {...}, nëse do të ngrihet në detyrë në gjykatat ku ajo ka kandiduar, do të jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, referuar nenit 8 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Procedura, pasi ka kaluar në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, më datë 27 nëntor, Komisioni ia ka përcjellë rastin për shqyrtim përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë, në cilësinë e relatorit, në përfundim të këtij verifikimi paraprak, i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 392, nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Marçela Shehu**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve nga kandidatja znj. {...}. Për më shumë detaje, prapë fjalën dëshiroj t’ia japë zotit Toska.

**Ilir Toska:** Paraprakisht dua t’ju them që për kandidaten {...} që qenë relatore zonja Shehu. Zonja Shehu ka përgatitur relacionin për verifikimin paraprak të tre kritereve, sikundër ju ka përcjellë edhe projektvendimin për verifikimin e plotësimit të këtyre kritereve nga ana e zonjës {...}. Në kushtet e pamundësisë për arsye shëndetësore

të zonjës Shehu, mbasi kam komunikuar me të, me qëllim që procedura e vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë kandidatët që kanë konkurruar për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pra për pozicionet e shpallura në datën 7 tetor, unë po ju bëj prezent rezultatet e verifikimit, për efekt të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim që procedura të ecë dhe të mos pengohet thjesht nga mungesa ditën e sotme të zonjës Shehu.

Zonja {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020, që bën fjalë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Mbas kësaj, sikundër edhe në rastin e zonjës Dervishi, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit me vendimin e datës 5 nëntor 2020, ku në këtë rast si relatore për zonjën {...} është caktuar zonja Marçela Shehu. Nga ana e relatores janë ndjekur procedurat standarde të verifikimit, kryesisht edhe për tre kriteret formale të kandidimit pra për “përvojën profesionale minimale”, “mospasje të masës disiplinore në fuqi” dhe për “mosqenien në kushtet e papajtueshmërisë ambientale”. Informacioni është marrë nga gjykatat ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, po kështu është marrë edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë KLGJ-së.

Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale” ka rezultuar se zonja {...} është emëruar fillimisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 10 tetor 2012. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 23 janar 2014 ajo është emëruar përfundimisht si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vijon edhe aktualisht të ushtrojë këtë funksion.

Referuar këtyre të dhënave, rezulton se zonja {...} plotëson kriteret e përcaktuara nenin 47 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pra konkretisht përvojën 7-vjeçare dhe përvojën specifike 5-vjeçare në fushën përkatëse të së drejtës.

Sa i përket përvojës specifike është marrë informacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Informacioni është i detajuar në relacionin shpjegues të projekt-aktit të propozuar nga relatori i çështjes. Kryesisht zonja {...} ka qenë në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit. Ka rezultuar që zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”, zonja {...} ka plotësuar rregullisht formularin përkatës lidhur me këtë kriter, ndërkohë që nuk rezulton ndonjë e dhënë sipas të cilës zonja {...} në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë do të jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, përcaktuar kjo në nenit 8 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Paraprakisht, relatorja e ka përcjellë rastin përpara KZHK-së, i cili më datë 20 nëntor 2020 ka vendosur që procedura është e plotë dhe rasti t’i përcillet për shqyrtim KLGJ-së.

Nga ana e saj relatorja zonja Shehu i ka propozuar Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë në fushën penale, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë në fushën penale, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë gjë lidhur me projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 394, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 394, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve për kandidaten znj. {...}. Edhe ky projekt-akt do relatohet nga zoti Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Znj. {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 07.10.2020 për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht të tre pozicionet janë në fushën e të drejtës civile (*sqarim: në fakt, janë dy pozicione në fushën e të drejtës civile dhe një pozicion në fushën e të drejtës penale*) dhe janë në Gjykatën e Apelit Tiranë, shpallur me vendimet nr. 394, nr. 395, nr. 396. Edhe në këtë rast Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit me vendimin e datës 5 nëntor 2020, ku pas shortit të hedhur, për kandidaten {...}, si relatores është caktuar znj. Marçela Shehu.

Nga ana e relatores janë ndjekur procedurat standarde për verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit dhe në veçanti sa i përket tre kriterëve formale të kandidimit, me qëllim vijimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për këtë candidate.

Lidhur me tre kriteret formale të kandidimit atë të “përvojës profesionale minimale”, “mospasje të masës disiplinore në fuqi” dhe “mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, informacioni është marrë nga gjykatat ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit po kështu është marrë edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë KLGJ-së.

Nga informacioni i marrë, sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale”, ka rezultuar se zonja {...} është emëruar fillimisht me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 27.01.2009 për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më pas, po me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 25 qershor 2010 ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Ndërkohë, duke filluar nga data 13 qershor 2018, fillimisht me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe më pas edhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja {...} është transferuar përkohësisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Referuar të dhënave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton që zonja {...} përmbush kriterin e “përvojës së përgjithshme profesionale” pra mbi 7 vjet, po ashtu përmbush edhe kriterin e “përvojës specifike profesionale” (pra në fushën e të drejtës civile) mbi 5 vjet. Të dhënat më të hollësishme nga gjykatat janë në relacionin shpjegues.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore”, përveç formularit të plotësuar nga vet kandidatja, është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe

Shërbimeve Administrative pranë Këshillit. Ka rezultuar që zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Edhe sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”, zonja {...} ka plotësuar rregullisht formularin përkatës, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja lidhur me situatën e papajtueshmërisë ambientale, për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Fillimisht, relatorja e çështjes e ka përcjellë rastin përpara KZHK-së, i cili më datë 20 nëntor 2020 ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit paraparak të tre kritereve duke ia përcjellë rastin për shqyrtim KLGJ-së.

Nga ana e relatores së çështjes, propozimi i saj është që Këshilli të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë (në fushën civile), për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394 dhe nr. 395 datë 07.10.2020 dhe në (fushën penale), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë (në fushën civile), për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020 dhe në (fushën penale), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 396, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 394, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në gjykatën e apelit tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.392, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.396, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në gjykatën e apelit tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.392, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.396, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve për kandidaten znj. {...}. Për këtë projekt-akt relator është z. Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Duke qenë që në mënyrë elektronike është shpërndarë materiali të gjithë anëtarëve, në mënyrë të sintetizuar ju bëj me dije përmbajtjen e informacionit.

Me vendimet nr. 392, 07.10.2020, nr. 395, 07.10.2020 dhe 396, 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit përkatësisht pranë Gjykatës së Apelit Durrës, në fushën e të drejtës civile (për një pozicion) dhe dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe atë penale në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në kuadër të përcaktimit tim si relator, kam filluar procedurat e verifikimit dhe kam administruar dokumentacionin e nevojshëm i cili provon plotësimin e kriterëve të parashikuara në nenin 47/4, 48/8, 8/3 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga këto të dhëna ka rezultuar që kandidatja ka mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu ajo ka mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile si dhe në fushën e të drejtës penale. Gjithashtu, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit nuk rezulton dhe nuk vërtetohet që kandidatja të ketë masë disiplinore në fuqi. Gjithashtu nuk vërtetohet që kandidatja të ndodhet në situatë papajtueshmëri ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në gjykatë apeli.

Pasi i ka kaluar Komisionit, ky i fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke propozuar draftin si më poshtë:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.392, nr. 395 datë 07.10.2020, dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile me



Vendimet nr.392, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr.396, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nga kolegët nuk ka ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, do i ftoj kolegët që të kalonim në votimin e tij.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në gjykatën e apelit tiranë për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.392, nr. 395 datë 07.10.2020 dhe për një pozicionin të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.396, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **znj. Marçela Shehu.**

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**

**4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

**5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

**7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kriterëve për kandidaten {...}. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020 ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për një

pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Afati i kandidimit është përcaktuar deri më datë 23 tetor 2020. Brenda afatit ka kandiduar edhe zonja {...}.

Më herët, zonja {...} ka kandiduar edhe për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020. Në këtë rast, në kuadër të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit të zonjës {...}, është bërë verifikimi paraprak i tre kriterëve dhe Këshilli me vendimin nr. 279, datë 08.09.2020 ka vendosur: 1. Verifikimin e plotësisë nga kandidatja zonja {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë, si më lart.

Aktualisht, kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, që po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Ndërkohë sa i përket kandidimit rishtazi nga ana e zonjës {...}, Këshilli me vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, ndërsa ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për të gjithë kandidatët që kishin konkurruar për pozicionet e lira të shpallura në datë 7 tetor 2020, ka vendosur që për kandidaten {...} të konsiderohen verifikimet e realizuara më herët sa i përket kriterëve dhe kushteve të kandidimit.

Gjithsesi është marrë informacion i mëtjshëm për periudhën mbas kandidimit të mëparshëm të zonjës {...}. Edhe në këtë rast është përfunduar verifikimi paraprak për tre kriteret formale të kandidimit edhe për kandidimin së fundmi dhe ka rezultuar (sikurse ka rezultuar edhe më herët) që kandidatja të plotësojë të tre kriteret e kandidimit, pra të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “papajtueshmërisë ambientale”.

Edhe në këtë rast, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, më datë 20, pasi ka shqyrtuar praktikën, duke e konsideruar të plotë praktikën e procedurës së verifikimit paraprak, ia ka përcjellë rastin për shqyrtim KLGJ-së.

Në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësisë nga kandidatja znj. {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësisë nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimi, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)



8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësisë nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me verifikimin e plotësisë të kritereve nga kandidati {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia kaloj relatorit të projekt-aktit, zotit Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 389, nr. 392 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, ka filluar procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit, përkatësisht pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Durrës dhe Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Me cilësinë e relatorit kam administruar dokumentacionin e nevojshëm i cili do të verifikonte kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në këto gjykata të apelit dhe nga vlerësimi i këtyre informacioneve ka rezultuar që kandidati zoti {...}, ka mbi 7 vjet përvojë të përgjithshme si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë. Gjithashtu ai rezulton të ketë mbi 5 vjet gjyqtar në fushën e të drejtës civile. Nga informacioni që ka ardhur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, nuk rezulton që ai të ketë masë disiplinore në fuqi. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, zoti {...} nuk ndodhet në një situatë papajtueshmërie ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në tre gjykatat Gjirokastër, Durrës dhe Tiranë.

Pasi i është kaluar Komisionit, ky i fundit ju propozon projektvendimin në të cilin ju propozohet: 1. Verifikimi i plotësimin nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile me Vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga kolegët, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr.389, nr. 392 dhe nr.395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

8. *Alban Toro* (anëtar)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
7. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit z. Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për zbatimin e vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatën znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Lidhur me këtë projektvendim ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues. Shkurtime mund t’ju them se:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësisë kushtetuese për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, si dhe të funksionit kushtetues të propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, që përcakton Kushtetuta nenet 147, 136/1 dhe 147/a, të materializuara më tej dhe në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (nenet 85 dhe 86), si dhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (nenet 47 dhe 48), në zbatim të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, pas përfundimit, më datë 30.07.2020, të afatit të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale dhe një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e tij nr. 241, nr. 242, nr. 243, nr. 244 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, filloi procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për të gjithë kandidatët, nga radhët e gjyqtarëve, që kishin kandiduar për këto pozicione.

Konkretisht, me Vendimin nr.268, datë 07.08.2020, Këshilli vendosi:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020 (në fushat e të drejtës administrative dhe të së drejtës civile), me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës penale), si dhe me Vendimin nr.245, datë 09.07.2020 (në fushën e të drejtës administrative), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 6 ka vendosur: 6. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244,

datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces.”

Kundër këtij disponimi, pra të pikës 6, zonja {...} paraqiti ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

Gjykata Administrative e Apelit, me Vendimin nr. 93, datë 10.11.2020, vendosi:

“1. Pranimin pjesërisht të padisë së paditëses {...}.

2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286/6, datë 07.08.2020 “Për mospërfshirjen e znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

3. Lejimin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë të paditëses {...} për tre pozicione nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas vendimeve nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, duke urdhëruar palën e paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor të vijojë procedurat për paditësen për tre pozicione të lira, sipas preferencës së paditëses kandidate, ose në mungesë, sipas renditjes së tyre.

4. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit. ...”.

Më datë 19.11.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar për njoftim Vendimi i arsyetuar nr. 93, datë 10.11.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Me Vendimin nr. 587, datë 20.11.2020, Këshilli vendosi:

“1. Të ushtrojë të drejtën e rekursit kundër Vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që i përket paditëses {...}. ...”.

Më datë 24.11.2020, Këshilli depozitoi rekursin kundër Vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Aktualisht Këshilli është në pritje të shqyrtimit të rekursit dhe marrjes së vendimit nga Gjykata e Lartë.

Pavarësisht nga sa më lart, në kushtet kur Vendimi nr.93, datë 10.11.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit është vendim i një gjykate të shkallës së dytë, që si i tillë është vendim i formës së prerë dhe, për rrjedhojë, i ekzekutueshëm, duke vlerësuar jo

dinjitoze për Këshillin pritjen e vënies në ekzekutim të detyrueshëm të këtij vendimi gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin për zbatimin e këtij vendimi.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë pikërisht për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këtë është mbajtur në konsideratë urdhërimi sipas pikës 3 të vendimit gjyqësor, të Gjykatës Administrative të Apelit, përmes të cilit është disponuar për: “Lejimin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë të paditëses {...} për tre pozicione nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas vendimeve nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, duke urdhëruar palën e paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor të vijojë procedurat për paditësen për tre pozicione të lira, sipas preferencës së paditëses kandidate, ose në mungesë, sipas renditjes së tyre”. Në këtë rast mbetet që paraprakisht, gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja të përcaktojë tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, për të cilat do të vijojë kandidimin.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se procedura e verifikimit të kandidates, përfshirë edhe sa i përket pasurisë dhe figurës, e realizuar për kandidimet e saj të mëparshme, është e vlefshme edhe për kandidimet e saj për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet e përmendura më lart. Për këtë është mbajtur në konsideratë fakti që kandidatja është në procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr.85, nr.86 dhe nr.87, datë 26.02.2020, procedura në të cilat janë realizuar verifikimet e nevojshme në lidhje me kriteret ligjore të kandidimit, përfshirë edhe si përket pasurisë dhe figurës, ku nisur nga kjo, çdo e dhënë e grumbulluar në këtë rast, sikundër edhe çdo vendimmarrje e Këshillit që është relevante edhe për procedurën e verifikimit rishtazi të kandidates në lidhje me kandidimet e saj për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, konsiderohet e vlefshme. Vlen të përmendet se në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të Këshillit



nr. 75, datë 23.05.2019, përcaktohet se: “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Procedura e verifikimit të kandidates, përfshirë edhe sa i përket pasurisë dhe figurës, e realizuar për kandidimet e saj të mëparshme, është e vlefshme edhe për kandidimet e saj për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

**Shënim 1:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**
- 7. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, z. {...}. Për më shumë detaje lidhur me projekt-aktin, fjalën ia jap zotit Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Zoti {...} është gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i caktuar si i tillë me Vendim nr.1 datë 30.03.1995 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Zoti {...}, më datë 27.11.2020 ka paraqitur një kërkesë me shkrim duke e depozituar pranë KLGJ-së, ku ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit. Në kërkesën e tij të datës 27.11.2020, ky i fundit ka kërkuar që konform nenit 65 pika 3 të Ligjit Nr.96/2016 “Për Statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë” dhënien e dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit” dhe si motiv të kërkesës së tij z. {...} ka parashtruar faktin: “... dorëheqjen time e paraqes për arsye të angazhimit tim në veprimtarinë akademike dhe të mësimdhënies. Për disa vite akademike jam angazhuar si

pedagog i jashtëm në Institucionin e Arsimit të Lartë “AU”. Me vendim nr. 261/5 datë 23.06.2020 kam marrë titullim “Doktor” në “E drejta Europiane dhe e kontratave” ...” (duke paraqitur edhe provat përkatëse bashkëlidhur).

Duke qenë që instituti i dorëheqjes bazohet në një akt vullnetar të magjistratit dhe ky akt është siguruar dhe qartësuar pranë institucionit të KLGJ-së nëpërmjet shkresës që ai ka paraqitur rregullisht pranë zyrës së protokollit, unë ju kam propozuar projektvendimin në dispozitivin e të cilit do të dëshiroja të konsideroni vetëm efektet e urdhërimit, të cilat unë i kam vendosur më datë 22.12.2020, por duke parë që kjo javë është e ngarkuar me festa zyrtare, ju ftoj ta konsideroni duke përcaktuar si efekt të fundit datën 31.12.2020. Pra përfundimisht, ju sugjeroj:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.12.2020 (në vend të 22.12.2020.)

3. Të përjashtojë gjyqtarin z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

**Brikena Ukperaj:** Kam një pyetje për Albanin (relatorin).

Në relacion është shkruar që dorëheqja është për shkaqe të motivuara, ndërkohë që në qoftë se ne do vendosim datën 31.12., në fakt është një dorëheqje normale.

**Maksim Qoku:** Është dorëheqje normale. Ndryshon votimi im pastaj.

**Brikena Ukperaj:** Ju pranoni që është dorëheqje e motivuar dhe vendosni afat fundin e muajit pasardhës apo keni ndryshuar qëndrim dhe thoni që është dorëheqje normale?

**Alban Toro:** Atëherë, fatmirësisht nga ana e relatorit procedohet duke qenë transparent me aktet që sjellë magjistrati, të cilat ju janë dërguar në formatin “.pdf”, pra nuk është vetëm \_\_\_\_ (min 2:11:20). Në këto akte gjyqtari ka kërkuar që dorëheqja të jetë e motivuar dhe me afate kohore të ngutshme, pra siç përcakton dispozita. Por në kushtet kur ai nuk ka përcaktuar një datë se kur i ka filluar kontrata e punës me institucionin arsimor edukues, unë kisha vendosur datën 22, duke qenë një datë e ndërmjetme midis procedurës normale dhe asaj të përshpejtuar. Por në kushtet kur edhe kjo javë është e ngarkuar me festa zyrtare, dhe shoh që zotëria (magjistrati) nuk ka ndonjë ngutshmëri sepse përndryshe do të kishte përcaktuar një datë fikse, ju propozoj datën 31, ku do të ketë kohë të bëjë edhe dorëzimet, etj., etj., dhe ta mbylli të paktën këtë vit me veshjen e magjistratit.

**Brikena Ukperaj:** Unë prapë nuk e kuptova, por gjithsesi.

**Naureda Llagami:** Diskutim tjetër?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord për efektet në datën 31 dhjetor, duke e konsideruar personalisht si një dorëheqje me motive të zakonshme dhe që shkon në përputhje me paragrafin 2 të nenit - “në fund të muajit pasardhës”. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Kundër me këtë propozim sepse mendoj, siç kam mbajtur qëndrim edhe në rastet e tjera, që dorëheqja duhet të japë efektet ditën që ka kërkuar gjyqtari, dhe nuk mendoj se është data e fundit e muajit pasardhës, pasi tek kërkesa e tij ai thotë e dua me efekte sipas pikës 3 të nenit 65. Kështu që jam kundër këtij varianti.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Dakord për mbarimin, por jo sipas nenit 65, pika 3, por sipas nenit 65, pika 2.

**Medi Bici:** Kundër. Jam me të njëjtin arsyetim që arsyeton zonja Brunilda.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.12.2020.

3. Të përjashtojë gjyqtarin z. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 15 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:36 dhe mbaroi në orën 12:05.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtare)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.



*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 8. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

15. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur relacionet për tre gjykata në nevojë: Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër**, ka paraqitur nevojë në 2 çështje në lëndë penale dhe civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Desart Avdulaj.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e 15 apo më shumë çështjeve në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z.Izet Dushaj; Znj.Anita Mici; Z.Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile dhe çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë**, ka paraqitur nevojë në 1 çështje në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë, dhe numri i

gjqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1. Ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë përzgjedhur me shortin e fundit, atë të datës 02.12.2020, për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht gjyqtarëve Maria Qirjazi dhe Zegjine Sollaku.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Nga ana e kësaj gjykate është nisur një kërkesë jo në formatin e përcaktuar me vendimin e Këshillit nr. 30/2019, ndërsa nuk kishte asnjë informacion për papajtueshmëri të funksionit të gjyqtarëve të asaj gjykate lidhur me gjykimin e asaj çështjeje. Ndaj i është kërkuar gjykatës informacioni si dhe plotësimi i formularit standard. Në përgjigje të saj, Gjykata e Durrësit ka nisur formularin standard të plotësuar, por në këtë formular sikundër edhe në shkresën përcjellëse nuk referon asnjë të dhënë për papajtueshmërinë e gjyqtarëve të saj lidhur me shqyrtimin e asaj çështjeje konkrete por referohet se më herët Ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka caktuar për gjykimin e asaj çështjeje një gjyqtar nga një gjykatë tjetër, z. Genti Dokollari, për shkak se një nga palët në proces ka qenë bashkëshort e një nga gjyqtarët që ushtronte funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Lidhur me këtë rast KZHK konsideron se lidhur nga aktet, në lidhje me çështjen sipas kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk rezulton që kjo gjykatë të jetë në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë gjyqtarëve të saj për gjykimin e asaj çështjeje, sa kohë nuk ka asnjë të dhënë për dorëheqje të miratuara apo për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, situata e mëparshme, mbi të cilën ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka disponuar me Vendimin nr.54, datë 19.11.2018, për delegimin e

gjqtarit Genti Dokollari për gjykimin e asaj çështjeje, është krejt e ndryshme me situatën aktuale, ndërsa znj. Ema Gashi nuk është më gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës prej datës 30.06.2019.

Në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor ku bazohet kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht në Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, Kreun III të tij, përcaktohet se “Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë” nënkupton caktimin e një gjyqtari, nga gjykata ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në një gjykatë tjetër, kur kjo e fundit ka një nevojë konkrete që lidhet me gjykimin e një ose disa çështjeve gjyqësore”, sikurse po ashtu përcaktohet edhe se: “Nevojat e gjykatës” nënkupton mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të gjyqtarëve të një gjykate për gjykimin e një apo disa çështjeve gjyqësore”.

Ndaj sa më sipër, është rasti që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë refuzimin e kërkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Për këtë arsye, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.3228 prot., datë 24.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për caktim gjyqtari, në çështjen civile me palët respektive që evidentohen në relacion.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Me këtë çështje të rendit të ditës mbyllet rendi i ditës i parashikuar për t'u realizuar me anë të platformës “online”. Pikë e fundit e rendit të ditës, seanca dëgjimore që do të zhvillohet me magjistratin z. Kuqo, nga ana e Këshillit, sipas rregullave që aplikohen për shkak të situatës së pandemisë, janë marrë masat që një pjesë e anëtarëve do të jenë prezent në ambientet e Këshillit dhe pjesa tjetër do të jenë prezent “online” nëpërmjet platformës.

\* \* \*

(Pika 15 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 10.12.2020)*

**Pika 16 e rendit të ditës me objekt:** Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vijon nga mbledhja plenare e datës 26.11.2020 - konkluzionet përfundimtare nga magjistrati).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:22 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Alban Toro</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

*Shënim 1:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Marçela Shehu*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Periant Teta, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 6. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (në sallë).*
- 7. Marçela Kuqo, përfaqësuese ligjore e magjistratit {...} (në sallë).*

#### **RENDI I DITËS:**

16. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vijon nga mbledhja plenare e datës 26.11.2020 - konkluzionet përfundimtare nga magjistrati).

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

*(Përpara se të hapet seanca dëgjimore, konfirmohet prezenca e anëtarëve, përveç zonjës Shehu).*

Në linjë është edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, zoti Metani.

*Artur Metani:* Po!

*Naureda Llagami:* Po çelim seancën dëgjimore e cila ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit zotit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo çështje vijon nga seanca dëgjimore e mëparshme e datës 26.11.2020. Në atë

seancë, siç jeni në dijëni, në përfundim të paraqitjes së provave dhe argumenteve nga palët, Inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqiti edhe konkluzionet përfundimtare lidhur me çështjen, ndërsa magjistrati kërkoi kohë për paraqitjen e tyre.

Duke marrë në konsideratë këtë kërkesë, Këshilli vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore për ditën e sotshme, datë 10.12.2020, duke i lënë detyrë magjistratit dorëzimin e konkluzioneve përfundimtare brenda datës 4 dhjetor 2020.

Duke çelur seancën dëgjimore, prezent në sallë?

{...}: Magjistrati {...} dhe mbrojtësja Marçela Kuqo.

**Naureda Llagami:** Ndërkohë “online” ndodhet zoti Metani.

Më lejoni t’ju informoj se zoti Kuqo ka paraqitur konkluzionet përfundimtare me datë 07.12.2020, konkluzione të cilat ju janë vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në respektim të procedurës, unë do doja të ftoja zotin Kuqo, në mënyrë të shkurtuar dhe të përmbledhur, të na parashtrojë edhe një herë konkluzionet, të cilat të gjithë anëtarët i kemi në dispozicion.

Për ty fjala zoti Kuqo!

{...}: Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Atëherë, në thelb të konkluzioneve të mia përfundimtare, parashtroj se:

“Për sa rezultoi e provuar në seancë dëgjimore, në aspektin procedural dhe atë material të përmbajtjes së tyre specifike, konkludoj se ndodhem para një procedimi disiplinor pa shkak të ligjshëm, që prej momentit kohor të fillimit të hetimit disiplinor. Kjo paligjshmëri referon në mungesën e shkaqeve dhe arsyeve referuese, faktike, ligjore, zbatuese, interpretative, ilustruese, krahasimore, etj., mbi rrethanat objekt procedimi disiplinor.

Veprimtaria e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këto drejtime, për sa rezultoi nga përmbajtja procedurale dhe materiale e seancave dëgjimore të zhvilluara, mbeti plotësisht me vlerësime jo ligjore, në disa raste tej kompetencës që ligja e kufizon në hetim dhe vlerësim, u paraqit si veprimtari tërësisht e njëanshme dhe e përmbushur vetëm



formalisht, tej realitetit objektiv procedural dhe material në çështjen objekt fillimin e procedimit disiplinor, si dhe pa asnjë pikë apo këndvështrim lidhës midis mënyrës së përmbushjes së detyrave funksionale të gjyshitës dhe argumentit që kjo gjykatë ka parashtruar, analizuar, argumentuar dhe konkluduar në zgjidhje të rastit kërkimor.

Garantoj Këshillin e Lartë Gjyqësor se e gjithë veprimtaria ime gjyqësore është mbështetur në respektim të plotë të ligjit dhe është ushtruar me integritet të plotë dhe i është nënshtruar vetëm bindjes së brendshme aq korrektësisht e ekspozuar.

Duke i qëndruar korrektësisht të gjithë argumenteve që kam paraqitur në këto konkluzione përfundimtare, kërkoj të vendos nën vërejtjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor preambulën apo thelbin e qëndrimit tim që formulohet nga një fjalë e vetme, që quhet dinjitet.

Mbështetur në gjithë sa më sipër, referuar sanksionit të nenit 146, pika 2, shkronja a) të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përfundimisht kërkoj që Këshilli i Lartë Gjyqësor të procedojë, me: Rrëzimin e kërkesës të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj magjistratit {...}, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkakun se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur dhe se ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

Vendos nga pikëpamja formale aktet dhe konkluzionet përfundimtare, sigluara në çdo fletë (gjithsej 91). Në materialin që dispononi janë 90, por është për shkak të formatit të printimit, është e njëjta përmbajtje. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Kuqo!

Mund t'i administrojmë aktet të lutem.

Në zbatim të rregullores, unë do t'ju ftoj zoti Kuqo të largoheni nga salla për të lejuar Këshillin për të vijuar procesin. Gjithashtu edhe zoti Metani, IT-ja do të mundësojë që juve të jeni jashtë linjës.

*(Dalin nga salla e mbledhjes magjistrati, z. {...} bashkë me avokaten znj. Marçela Kuqo, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani nga platforma "online". Vijohet diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve. Pas diskutimeve të anëtarëve rifuten në sallë palët.)*

**Naureda Llagami:** Jemi të gjithë në linjë?

Edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në linjë?

**Artur Metani:** Po!

**Naureda Llagami:** Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mënyrë unanime, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shkarkimin nga detyra të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
3. Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50% si dhe përfitimet e tjera të magjistratit {...}, deri kur ky vendim të marrë formë të prerë.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën Kushtetuese, afati i të cilit fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Me kaq mbyllet seanca dëgjimore dhe procedimi disiplinor.

\* \* \*

(Pika 16 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**